

**VENDIM NR. 2**  
**I ORTAKUT TË VETËM**  
**TË SHOQËRISË "S.S.X." SH.P.K.**

Sot, më datë 25.11.2016, në orën 14.00, pranë selisë së shoqërisë "S.S.X." Sh.p.k. me NIPT J618170700, (këtej e tutje "Shoqëria") ndodhur në Rrugën 5 Maji, (Brenda ish Ndërmarrjes Kimike) u mbajt Mbledhja e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë në të cilën:

**është i pranishëm personalisht**

- **Z. Saliko DAUTAJ**, i biri i Asllanit, lindur në Berat, më 06/02/1951, banues në Tiranë, në Rrugën "Sytki Ciço", Pall.2, Shk.1, Ap.1, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Leternjoftimit nr. 032939351 me nr. personal F10206121B, në cilësinë e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë.

Ortaku i Vetëm pas një shqyrtimi të gjërë të çështjeve të rendit të ditës si:

1. Fillimi i Proçedurave ligjore për rritjen e kapitalit themeltar të Shoqërisë;
2. Emërimi i një Eksperti Kontabël të Rregjistruar, për të vlerësuar këtë rritje.
3. Ndryshimi i kuotave të kapitalit nga 100 (njëqind) kuota në 1 (një) kuota e cila i përket Ortakut të Vetëm të Shoqërisë

VENDOSI

1. Fillimin e Proçedurave ligjore për rritjen e kapitalit themeltar të Shoqërisë, nëpërmjet fitimeve të mbartura dhe fitimeve të vitit ushtrimor 2015 sipas gjendjes në bilancin e mbylljes së vitit, të krijuara deri më 31 dhjetor 2015, për 20.000.000 (njëzetëmilion) lekë;
2. Emërimin e znj. Fatbardha Shtrepi, anëtare e IEKA, me profesion "Ekspert Kontabel i Rregjistruar", me License Nr. 130 date 28.12.2001 për të vlerësuar Rritjen e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë, nëpërmjet fitimeve të mbartura dhe fitimeve të vitit ushtrimor 2015 sipas gjendjes në bilancin e mbylljes së vitit, të krijuara deri më 31 dhjetor 2015, si dhe të paraqesë Raportin e Ekspertimit Kontabël për këtë qëllim.
3. Kapitali i Shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuota dhe i përket Ortakut të Vetëm të Shoqërisë.

\* \* \* \* \*

Meqënëse nuk kishte çështje të tjera për tu shqyrtuar, Ortaku i Vetëm e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 14.30. Ky Vendim mbahet në 3 (tre) kopje origjinale, në gjuhën shqipe.

Ortaku i Vetëm,

  
Saliko DAUTAJ

